



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE BASHKËPUNIMIT
NDËRKOMBËTAR

Nr. ... Prot.

Tiranë, më _____ 2010

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Kulturor midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë, Ministria e Arsimit dhe Çështjeve Fetare të Republikës së Greqisë ofron për shtetasit shqiptarë bursat e mëposhtme, për vitin akademik 2010-2011:

- 2 (dy) bursa për studime pasuniversitare ose kërkimore;
- 2 (dy) bursa për ndjekjen e kursit të verës për gjuhën dhe qytetërimin grek;

Aplikantët duhet të paraqesin pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dokumentet e mëposhtme:

Për studime pasuniversitare:

1. Kërkesën drejtuar MASH-it, ku të specifikohet fusha e studimit;
2. Diplomën e shkollës së lartë, fotokopjen e noterizuar;
3. Listën e notave, fotokopjen e noterizuar;
4. Dëshminë për njohjen e gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht ose greqisht);
5. Dy letra rekomandimi;
6. Programin e studimit;
7. Raportin mjekësor për aftësi studimesh;
8. Fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës;
9. CV;
10. Dëshminë e pranimit nga një universitet në Greqi ose nga një institucion kërkimor-arsimor.
11. 4 fotografi 4cm x 6 cm.

Për kursin e verës:

1. Fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës;
2. Diplomën e mbarimit të studimeve të larta si dhe certifikata të tjera që vertetojnë kualifikimet e kandidatit;
3. Dëshmitë për njohjen e gjuhëve të huaja, nëse ka;
4. CV;
5. Raportin mjekësor;
6. 4 fotografi 4 cm x 6 cm.

Dokumentet e kërkuara duhet të jenë të përkthyer në greqisht ose në anglisht dhe të noterizuara. Afati i fundit për pranimin e dokumentacionit është data 05.03.2010.

Për një informacion më të hollësishëm lidhur me mënyrën e plotësimit të formularit të aplikimit dhe përgatitjes së dokumentacionit, referojuni adresës së internetit: www.ypepth.gr/docs;

Për çdo informacion tjetër mund të merrni në numrin e telefonit 04 2230197.

SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Adresa: "Rruga Durrësit"
Nr. 23, AL 1001, Tiranë
Tel: +355 4 2230197, Fax : +355 4 2232002

web site: www.mash.gov.al